



Data: 05.02.2019

Ref.: 142/190

Në mbështetje të Nenit 4 dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Neni 7, dhe Neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" si më poshtë:

1.1 Fakulteti i Edukimit:

- 1.1.1 Pedagogji e Përgjithshme, BA, 180 ECTS
- 1.1.2 Programi Fillor, BA, 240 ECTS
- 1.1.3 Programi Parashkollor, BA, 240 ECTS
- 1.1.4 Udhëheqja në Arsim, MA, 90 ECTS

1.2 Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë:

- 1.2.1 Menaxhimi i Biznesit në Zootekni, BSc, 180 ECTS

1.3 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike:

- 1.3.1 Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti, BSc, 180 ECTS

1.4 Fakulteti i Mjekësisë:

- 1.4.1 Infermieri, BSc, 180 ECTS

1.5 Fakulteti Filozofik:

- 1.5.1 Psikologji, BA, 180 ECTS
- 1.5.2 Shkenca Politike, BA, 180 ECTS

1.6 Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës:

- 1.6.1 Gjeodezi, BSc, 180 ECTS

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Sipas Nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, *“IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor”*, pra IAL-të janë të obliguara që të deklarojnë stafin akademik më së largu deri me 31 tetor 2018. Sipas pikën 3 të Nenit 30 të UA për Akreditim, *“Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit”.*

Pas deklarimit të stafit akademik të IAL-ve, AKA ka bërë verifikimin e dokumentacionit të tyre me qëllim të konfirmimit të kriterëve ligjorë për secilin program të studimit. Në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019, KShC analizoi në detaje gjithë dokumentacionin e stafit akademik të përcaktuar si bartës të programeve nga IAL-të dhe mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Fakulteti i Edukimit:

1. Për programin e studimit: *Pedagogji e Përgjithshme, BA, 180 ECTS*, bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Edukimit ka paraparë këtë staf: Majlinda Gjelaj (PhD në Pedagogji), Kyvete Shatri (PhD në Shkenca Ekonomike) dhe Qazim Elshani (PhD në Shkenca të Sportit).

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit UP, Fakulteti i Edukimit duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës, nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky fakultet për këtë program të studimit, u konstatua që vetëm Majlinda Gjelaj i përket fushës së programit të studimit *Pedagogji e Përgjithshme*, ndërsa Kyvete Shatri, dhe Qazim Elshani nuk i përkasin fushës së programit të studimit. Kyvete Shatri është PhD në Shkenca Ekonomike, ndërsa Qazim Elshani është PhD në Shkenca Sportive.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të tërheq akreditimin për programin e studimit *Pedagogji e Përgjithshme, BA, 180 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Programi Fillor, BA, 240 ECTS* bartës të këtij programi Fakulteti i Edukimit ka paraparë këtë staf: Hatixhe Ismajli (PhD në Shkenca të Pedagogjisë), Myrvete Dreshaj Baliu (PhD

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë:

1. Për programin e studimit: *Menaxhimi i Biznesit në Zootekni, BSc, 180 ECTS* si bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Edukimit ka paraparë këtë staf: Hajrip Mehmeti, Alltane Kryeziu dhe Muhamet Kamberi.

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Pas analizës së stafit të prezantuar u konstatua se asnjëri nga bartësit e lartëcekur nuk mbulon fushën e Menaxhimit të Biznesit. Andaj bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të tërheq akreditimin për programin e studimit *Menaxhimi i Biznesit në Zootekni, BSc, 180 ECTS*.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike:

1. Për programin e studimit: *Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti, BSc, 180 ECTS* bartës të këtij programi UP, Fakulteti Inxhinierisë Mekanike ka paraparë këtë staf: Hysni Osmani (PhD në Shkenca Teknike), Nexhat Qehaja (PhD në Shkenca Teknike) dhe Fitore Abdullahu (PhD në Shkencat e Matematikës).

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Pas analizës së stafit të prezantuar u konstatua se asnjëri nga bartësit e lartëcekur nuk vjen nga fusha e menaxhmentit.

Bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të tërheq akreditimin për programin e studimit *Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti, BSc, 180 ECTS*.

Fakulteti i Mjekësisë:

1. Për programin e studimit: *Infermieri, BSc, 180 ECTS*, bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Mjekësisë ka paraparë këtë staf: Antigona Hasani (PhD në Shkencat e Mjekësisë), Ardiana Murtezani (PhD në Shkencat e Mjekësisë) dhe Hasime Qorraj Bytyqi (PhD në Shkencat e Mjekësisë).

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Pas analizës së stafit të prezantuar nga Fakulteti i Mjekësisë u konstatua se asnjëri nga bartësit e lartëcekur nuk mbulon fushën e programit të studimit në Infermieri. Për më tepër, në këtë program janë shkelë kushtet e akreditimit të dhënë me vendimin paraparak.

Bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të tërheq akreditimin për programin e studimit *Infermieri, BSc, 180 ECTS*.

Fakulteti Filozofik:

1. Për programin e studimit: *Psikologji, BA, 180 ECTS*, bartës në këtë program UP, Fakulteti Filozofik ka paraparë këtë staf: Liridona Jemini-Gashi, Fitim Uka dhe Meliha Brestovci.

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.


Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga UP, Fakulteti Filozofik për këtë program të studimit, u konstatua që Meliha Brestovci nuk mund të jetë bartëse e këtij programi pasi që i përket fushës së Filologjisë, fushë kjo e cila nuk ka ndërlidhet me Psikologjinë.

Bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të tërheq akreditimin për programin e studimit *Psikologji, BA, 180 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Shkenca Politike, BA, 180 ECTS* bartës në këtë program UP, Fakulteti Filozofik ka paraparë këtë staf: Adem Beha (PhD në Shkenca Politike), Bardhok Bashota (PhD në Histori, në profilin: Marrëdhënie ndërkombëtare), Afrim Hoti PhD në Filozofi, për Organizimi dhe Menaxhimi Jashtë Sferës së Prodhimit Material (Siguria Kombëtare).

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga UP, Fakulteti Filozofik për këtë program të studimit, u konstatua që Adem Beha dhe Bardhok Bashota plotësojnë kriteret formale për bartës të programit, ndërsa Afrim Hoti nuk mund të jetë bartës i programit të studimit në Shkenca Politike sipas legjislacionit në fuqi.



Data: 05.02.2019

Ref.: 142/190

Në mbështetje të Nenit 4 dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Neni 7, dhe Neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" si më poshtë:

1.1 Fakulteti i Edukimit:

- 1.1.1 Pedagogji e Përgjithshme, BA, 180 ECTS
- 1.1.2 Programi Fillor, BA, 240 ECTS
- 1.1.3 Programi Parashkollor, BA, 240 ECTS
- 1.1.4 Udhëheqja në Arsim, MA, 90 ECTS

1.2 Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë:

- 1.2.1 Menaxhimi i Biznesit në Zootekni, BSc, 180 ECTS

1.3 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike:

- 1.3.1 Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti, BSc, 180 ECTS

1.4 Fakulteti i Mjekësisë:

- 1.4.1 Infermieri, BSc, 180 ECTS

1.5 Fakulteti Filozofik:

- 1.5.1 Psikologji, BA, 180 ECTS
- 1.5.2 Shkenca Politike, BA, 180 ECTS

1.6 Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës:

- 1.6.1 Gjeodezi, BSc, 180 ECTS

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Sipas Nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, *“IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor”*, pra IAL-të janë të obliguara që të deklarojnë stafin akademik më së largu deri me 31 tetor 2018. Sipas pikën 3 të Nenit 30 të UA për Akreditim, *“Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit”.*

Pas deklarimit të stafit akademik të IAL-ve, AKA ka bërë verifikimin e dokumentacionit të tyre me qëllim të konfirmimit të kriterëve ligjorë për secilin program të studimit. Në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019, KShC analizoi në detaje gjithë dokumentacionin e stafit akademik të përcaktuar si bartës të programeve nga IAL-të dhe mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Fakulteti i Edukimit:

1. Për programin e studimit: *Pedagogji e Përgjithshme, BA, 180 ECTS*, bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Edukimit ka paraparë këtë staf: Majlinda Gjelaj (PhD në Pedagogji), Kyvete Shatri (PhD në Shkenca Ekonomike) dhe Qazim Elshani (PhD në Shkenca të Sportit).

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit UP, Fakulteti i Edukimit duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës, nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky fakultet për këtë program të studimit, u konstatua që vetëm Majlinda Gjelaj i përket fushës së programit të studimit *Pedagogji e Përgjithshme*, ndërsa Kyvete Shatri, dhe Qazim Elshani nuk i përkasin fushës së programit të studimit. Kyvete Shatri është PhD në Shkenca Ekonomike, ndërsa Qazim Elshani është PhD në Shkenca Sportive.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të tërheq akreditimin për programin e studimit *Pedagogji e Përgjithshme, BA, 180 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Programi Fillor, BA, 240 ECTS* bartës të këtij programi Fakulteti i Edukimit ka paraparë këtë staf: Hatixhe Ismajli (PhD në Shkenca të Pedagogjisë), Myrvete Dreshaj Baliu (PhD

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë:

1. Për programin e studimit: *Menaxhimi i Biznesit në Zootekni, BSc, 180 ECTS* si bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Edukimit ka paraparë këtë staf: Hajrip Mehmeti, Alltane Kryeziu dhe Muhamet Kamberi.

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Pas analizës së stafit të prezantuar u konstatua se asnjëri nga bartësit e lartëcekur nuk mbulon fushën e Menaxhimit të Biznesit. Andaj bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të tërheq akreditimin për programin e studimit *Menaxhimi i Biznesit në Zootekni, BSc, 180 ECTS*.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike:

1. Për programin e studimit: *Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti, BSc, 180 ECTS* bartës të këtij programi UP, Fakulteti Inxhinierisë Mekanike ka paraparë këtë staf: Hysni Osmani (PhD në Shkenca Teknike), Nexhat Qehaja (PhD në Shkenca Teknike) dhe Fitore Abdullahu (PhD në Shkencat e Matematikës).

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Pas analizës së stafit të prezantuar u konstatua se asnjëri nga bartësit e lartëcekur nuk vjen nga fusha e menaxhmentit.

Bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të tërheq akreditimin për programin e studimit *Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti, BSc, 180 ECTS*.

Fakulteti i Mjekësisë:

1. Për programin e studimit: *Infermieri, BSc, 180 ECTS*, bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Mjekësisë ka paraparë këtë staf: Antigona Hasani (PhD në Shkencat e Mjekësisë), Ardiana Murtezani (PhD në Shkencat e Mjekësisë) dhe Hasime Qorraj Bytyqi (PhD në Shkencat e Mjekësisë).